



REPUBLIKA E KOSOVËS- REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA HANI I ELEZIT



Datë: 04.06.2024
Komuna Hanit i Elezit
Rrg. Nuri Bushi nr.2

Në bazë të vendimit të Kuvendit të Komunës me nr. 3464/2024 të dt. 30.04.2024, nenit 68 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, neni 28 dhe 31 të Ligjit për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja nr.08/L-025 si dhe Udhëzimit Administrativ nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, Kryetari i Komunës shpallë për diskutim publik Projekt Planin Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit 2024-2029.

NJOFTIM SHPALLJE PUBLIKE DHE PJESËMARRJE NË DISKUTIM PUBLIK

Komuna e Hanit të Elezit përmes këtij njoftimi fton dhe njofton trupat konsultative, publikun e gjërë, ekspertët e fushave dhe të gjithë të interesuarit që të marrin pjesë dhe japin kontributin e tyre në aspektin e vërejtjeve, sugjerimeve, propozimeve dhe plotësimeve të Projekt Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit 2024-2029.

Shqyrtimi kryesor publik i Draft Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit do të mbahet me dt.09.07.2024 (e marte) me fillim nga ora 10.30 në sallën e takimeve të Asamblesë Komunale.

Draft Planin Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit 2024-2029 mund ta gjeni në ëeb faqen e Komunës së Hanit të Elezit, në linkun: <https://kk.rks-gov.net/haniielezit/category/konsultime-publike/> i cili do të jetë aty nga dt.27.06.2024 viti.

Afati për shprehje të mendimeve, sugjerimeve, komenteve e vërejtjeve për këtë propozim dokument do të jetë nga data **26.06.2024 deri me 27.07.2024**.

Komentet, vërejtjet, propozimet si dhe sugjerimet e juaja mund ti drejtoni në email adresën: Fatbardha.h.bushi@rks-gov.net. Apo bardha.bushi@gmail.com. Ose mund ti dorëzoni në kopje fizike në zyrën e Zyrtares Komunale për Mbrojtjen e Mjedisit Fatbardha Bushi.

Ju lutemi për prezencë dhe kontribut.

Hani i Elezit
26.06.2024

Kryetari i Komunës
Mehmet Ballazhi

